



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.108

2004

dhjetor

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.895, datë 26.11.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.64, datë 29.1.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e programit analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2004”..... 7145
Vendim i KM nr.897, datë 29.12.2004	Për disa ndryshime në vendimin nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar..... 7148
Vendim i KM nr.898, datë 29.12.2004	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zbatimi i programit “PHARE” për projektet e rehabilitimit të kanaleve të ujërave të zeza, në rrugën në veri të ish-kombinatit të konservave dhe të sistemim-asfaltimit të rrugës nr.5 (Segmenti shkolla “Ali Demi”-rruga nr.3), në qytetin e Vlorës..... 7151
Vendim i KM nr.899, datë 29.12.2004	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës së varrezave të reja, në qytetin e Shijakut..... 7153
Vendim i KM nr.901, datë 29.12.2004	Për një ndryshim në vendimin nr.243, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve në ministritë dhe institucionet buxhetore, për vitin 2004, dhe për rishpërndarje fondesh buxhetore”..... 7154

Vendim i KM nr.906, datë 19.12.2004	Për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Mbikëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale.....	7155
Vendim i GJK nr.19, datë 23.12.2004	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr.93, datë 3.10.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetues.....	7155
Vendim i GJK nr.20, datë 23.12.2004	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.3587, datë 9.6.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1068, datë 9.10.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.581, datë 5.3.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si antikushtetuese.....	7159

VENDIM
Nr.895, datë 26.11.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.64, DATË 29.1.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT ANALITIK TË PROJEKTAKTEVE,
QË DO TË PARAQITEN PËR SHQYRTIM NË KËSHILLIN E MINISTRAVE,
GJATË VITIT 2004”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.64, datë 29.1.2004 të Këshillit të Ministrave në tabelën “Programi i përgjithshëm analitik i projektakteve për vitin 2004, Ministria e Drejtësisë”, të bëhen ndryshimet sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Ngarkohet Ministri i Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

OBJEKTIVA TË RISHIKUARA
PROGRAMI I PËRGJITHSHËM ANALITIK I PROJEKTAKTEVE PËR VITIN 2004
(VENDIMI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.64, DATË 29.1.2004)

Nr.	Projektakti	Afati i programuar për paraqitjen në Këshillin e Ministrave (Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.64, datë 29.1.2004)	Afati i rishikuar për paraqitjen në Këshillin e Ministrave	Komente të lidhura me paraqitjen e projektit në Këshillin e Ministrave
7	Projektligj për përgjegjësinë penale të personave juridikë	Maj	Dhjetor	Vonesa për mendimet e kërkuara: M.Financave P.Përgjithshme
10	Projektligje lidhur me përdorimin e kamerave në vende publike dhe private për efekt të sigurisë publike dhe ndjekjes penale	Nëntor	Dhjetor	Bashkërendimi me P.Përgjithshme M.R.Publik M.Financave M.Integrimit
11	Projektligj për bashkëpunimin gjyqësor dhe ligjor ndërkombëtar	Korrik	Qershor 2005	Bashkërendimi me P.Përgjithshëm M.P.Jashtme M.Financave M.R.Publik M.Integrimit

13	Paketa ligjore për drejtësinë e të miturve me shtesa dhe ndryshime në legjislacionin penal etj., si dhe në organizimin dhe funksionimin e sistemit të drejtësisë	Nëntor	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e drejtësisë dhe asistencën e huaj të programuar
14	Projektligj për kompensimin për burgim të padrejtë	Tetor	Dhjetor	Bashkërendimi me M.Financave M.Integritetit P.Përgjithshme
15	Projektligj kundër zvarritjeve në procesin hetimor dhe gjyqësor, si dhe përgjegjësisë përkatëse ndaj të tretëve	Tetor	Shtator 2005	Bashkërendimi me organet gjyqësore KLD P.Përgjithshëm M.Financave M.Integritetit
16	Projektligj për faljet dhe amnistinë	Gusht	Dhjetor	
17	Projektligj për ratifikimin e Konventës së OKB për korrupsionin	Maj	Dhjetor 2005	Në varësi të zhvillimeve ndërkombëtare dhe rishikimit të brendshëm
21	Projektligje për ratifikimin e protokolleve të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut (Protokolli i 13-të)	Shkurt	Dhjetor 2005	Në varësi të zhvillimeve ndërkombëtare dhe rishikimit të brendshëm
23	Projektligj për ndryshime në ligjin për shoqëritë tregtare	Gusht	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
24	Projektligj për ndryshime në ligjin për regjistrin tregtar	Gusht	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
25	Projektligj për shfuqizimin e pjesës së parë të Kodit Tregtar	Gusht	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar

26	Projektligj për të drejtën ndërkombëtare private	Nëntor	Qershor 2005	Bashkërendimi me organet gjyqësore M.P.Jashtme M.Integritetit
28	Projektligj për shtesa dhe ndryshime në ligjin për organizimin e pushtetit gjyqësor	Tetor	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
29	Projektligj për vlerësimin profesional të gjyqtarëve	Tetor	Shtator 2005	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
30	Projektligj për ndryshime në ligjin për shkollën e Magjistraturës	Korrik	Dhjetor	
34	Projekttakte nënligjore për funksionimin e Qendrës së Publikimeve Zyrtare	Mars	Dhjetor	
36	Projektligj për arbitrazhin	Maj	Dhjetor	Bashkërendim me institucionet e interesuara dhe asistencën e huaj të programuar
38	Rregullorja e brendshme e Ministrisë së Drejtësisë	Prill	Qershor 2005	Në varësi të unifikimit të hartimit të këtyre akteve në sistemin e qeverisjes

VENDIM
Nr.897, datë 29.12.2004

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.786, DATË 17.12.1998 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUALIFIKIMIN SHKENCOR PASUNIVERSITAR DHE
KLASIFIKIMIN E PUNONJËSVE PEDAGOGJIKË E KËRKIMORË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27 e 37 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3.8 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3.8 Pas miratimit të disertacionit të doktoratës nga juria, disertanti merr gradën “Doktor i shkencave”. Regjistrimi i diplomës bëhet në regjistrin përkatës, pranë sekretarisë së komisionit të kualifikimit shkencor dhe, pas kësaj, nënshkruhet nga dekani dhe rektori i universitetit përkatës.”.

2. Në pikën 4 të bëhen këto ndryshime:

a) Nën-pikat 4.2, 4.2.1, 4.2.2 dhe 4.2.3 ndryshohen si më poshtë vijon:

“4.2 Punonjësit pedagogjiko-shkencorë të shkollave të larta, në varësi nga vendi dhe roli që kanë në veprimtarinë e mësimdhënies e nga kontributi i tyre mësimor e shkencor, klasifikohen si vijon:

4.2.1 “Profesor” (Prof.) emërtohet punonjësi pedagogjiko-shkencor, i brendshëm, i shkollave të larta ose punonjësi pedagogjiko-shkencor, i jashtëm, i rregullt, i këtyre institucioneve, i miratuar zyrtarisht nga organet përkatëse, që ka gradën shkencore “Profesor i asociuar”, të paktën prej pesë vjetësh, dhe që gjatë kësaj periudhe është ose ka qenë:

- titullar lëndësh a grup lëndësh;
- udhëheqës diplomash të shkollave pasuniversitare ose të paktën i një disertacioni;
- autor ose bashkautor kryesor i të paktën një teksti universitar, të miratuar nga fakulteti përkatës ose i një monografie;
- hartues programesh për të paktën një lëndë a cikël lëndësh të veçanta;
- autor artikujsh shkencorë, jo më pak se pesë;
- drejtues studimesh a projektsh shkencorë;
- drejtues seksioni, katedre, departamenti ose ekipi kërkimor;
- pjesëmarrës me referate a kumtesa në kongrese apo konferenca shkencore, brenda dhe jashtë vendit, dhe ka botuar artikuj a kumtesa jashtë vendit.

Niveli i punimeve kryesore të kandidatit, të përzgjedhura nga vetë ai, si monografi (tekste) ose, në vend të tyre, artikuj shkencorë, vlerësohet nga dy oponentë, të cilët caktohen nga kryetari i senatit të universitetit ose kryetarët e seksioneve të Akademisë së Shkencave. Në veprat me bashkautorësi oponentët përcaktojnë edhe kontributin e çdo kandidati.

Përfundime bëhen vetëm me vendim të komisionit të kualifikimit shkencor, por përfundimet nuk mund të cenohen afatin kohor të përcaktuar për kërkimin e titullit dhe as rregullin e kapërcimit të shkallëve të vendosura për fitimin e titujve.

4.2.2 “Profesor i asociuar” (Prof.asoc.) emërtohet punonjësi pedagogjiko-shkencor, i brendshëm, i shkollave të larta, ose punonjësi pedagogjiko-shkencor i jashtëm, i rregullt, i këtyre institucioneve, i miratuar zyrtarisht nga organet përkatëse, i cili ka gradën shkencore “Doktor i shkencave”, të paktën prej pesë vjetësh, me përvojë mësimdhënieje prej jo më pak se dhjetë vjetësh në shkollën e lartë, nga të cilat tre vitet e fundit pandërprerje, që zotëron, sipas dëshmisë përkatëse, njëherë nga gjuhët kryesore anglisht, frëngjisht a gjermanisht dhe, në rast nevojë, një gjuhë të dytë, të caktuar zyrtarisht nga dekani a drejtori përkatës dhe që është:

- titullar lënde;
- autor ose bashkautor i të paktën një teksti universitar, të miratuar nga fakulteti përkatës, ose monografie;
- autor i jo më pak se pesë artikujve e kumtesave të botuara, brenda dhe jashtë vendit;
- realizues projektesh a studimesh të rëndësishme shkencore;
- udhëheqës (pas përfundimit të doktoratës) i punimeve të diplomave universitare ose pasuniversitare.

Përrjashtime bëhen vetëm me vendim të komisionit të kualifikimit shkencor, por përrjashtimet nuk mund të cenojnë afatin kohor të përcaktuar për kërkimin e titullit.

4.2.3 “Lektor” emërtohet punonjësi akademik, i brendshëm, i shkollave të larta, me gradë shkencore “Doktor i shkencave”, që jep leksione, është autor artikujsh shkencorë dhe ka udhëhequr diploma universitare ose pasuniversitare.”.

b) Nënpiakat 4.3, 4.3.1 dhe 4.3.2 ndryshohen si më poshtë vijon:

“4.3 Punonjësit kërkimorë të institucioneve kërkimore-shkencore dhe punonjësit kërkimorë-shkencorë të shkollave të larta, në varësi nga niveli shkencor dhe kontributi personal, si dhe nga vendi që zënë në veprimtarinë kërkimore-shkencore, klasifikohen:

4.3.1 “Profesor” (Prof.) emërtohet punonjësi i brendshëm, kërkimor-shkencor, i institucioneve shkencore ose i shkollave të larta apo bashkëpunëtori i jashtëm, i rregullt, i këtyre institucioneve, i miratuar zyrtarisht nga organet përkatëse, që është:

- “Profesor i asociuar”, prej jo më pak se pesë vjetësh dhe që gjatë kësaj periudhe drejton ose ka drejtuar kërkime në fushën e vet;

- autor ose bashkautor kryesor i të paktën dy monografive;
- autor a bashkautor kryesor i të paktën një monografie dhe një teksti universitar, të miratuar nga fakulteti përkatës;

- autor i të paktën dhjetë artikujve shkencorë, brenda e jashtë vendit;
- udhëheqës i të paktën një disertacioni për doktoratë;
- pjesëmarrës, në mënyrë të vazhdueshme, në veprimtari shkencore, brenda dhe jashtë vendit, me komunikime gojore ose me postera.

Për specialitete të veçanta, në mungesë të monografive dhe të teksteve universitare, duhet të ketë botuar të paktën dhjetë artikuj të tjerë, brenda e jashtë vendit.

Niveli i punimeve kryesore të kandidatit, të përzgjedhura nga vetë ai, si monografi (tekste) ose, në vend të tyre, artikuj shkencorë, vlerësohet nga dy oponentë, të cilët caktohen nga kryetari i senatit të universitetit ose kryetarët e seksioneve të Akademisë së Shkencave. Në veprat me bashkautorësi, oponentët përcaktojnë edhe kontributin e çdo kandidati.

Përrjashtime bëhen vetëm me vendim të komisionit të kualifikimit shkencor, por përrjashtimet nuk mund të cenojnë afatin kohor të përcaktuar për kërkimin e titullit dhe as rregullin e kapërcimit të shkallëve të vendosura për fitimin e titujve.

4.3.2 “Profesor i asociuar” (Prof.asoc.) emërtohet punonjësi kërkimor-shkencor i institucioneve shkencore apo i shkollave të larta ose bashkëpunëtori i jashtëm, i rregullt, i këtyre institucioneve, i miratuar zyrtarisht nga organet përkatëse, i cili ka gradën shkencore “Doktor i shkencave”, prej jo më pak se pesë vjetësh, e që zotëron, me dëshmi përkatëse, njërën nga gjuhët kryesore anglisht, frëngjisht a gjermanisht dhe, në rast nevojë, një gjuhë të dytë, të caktuar zyrtarisht nga dekani a drejtori përkatës, dhe që ka:

- përvojë kërkimore, jo më pak se dhjetë vjet, nga të cilat tri vitet e fundit pandërprerje;
- botuar, si autor a bashkautor, të paktën një monografi ose një tekst universitar, të miratuar nga fakulteti përkatës;

- botuar të paktën pesë artikuj, si dhe kumtesa shkencore, nga të cilat dy jashtë vendit;
- marrë pjesë në realizimin e projekteve të rëndësishme kërkimore;
- kontribuar në shkolla pasuniversitare, nëse ka të tilla;
- marrë pjesë në konferenca shkencore, brenda ose jashtë vendit, me kumtesa ose postera.

Për specialitete të veçanta, në mungesë të monografisë a të tekstit universitar, duhet të ketë botuar dhjetë artikuj ose kumtesa shkencore, nga të cilat tre jashtë vendit.

VENDIM
Nr.898, datë 29.12.2004

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA ZBATIMI I PROGRAMIT “PHARE” PËR PROJEKTET E REHABILITIMIT TË KANALEVE TË UJËRAVE TË ZEZA, NË RRUGËN NË VERI TË ISH-KOMBINATIT TË KONSERVAVE, DHE TË SISTEMIM-ASFALTIMIT TË RRUGËS NR.5 (SEGMENTI SHKOLLA “ALI DEMI”-RRUGA NR.3), NË QYTETIN E VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private (truall dhe objekt), që preken nga rehabilitimi i kanaleve të ujërave të zeza, në rrugën në veri të ish-kombinatit të konservave, dhe nga sistemim-asfaltimi i rrugës nr.5 (segmenti shkolla “Ali Demi”-rruga nr.3), në qytetin e Vlorës.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Vlorës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 2 297,2 m² tokë truall dhe 873,16 m² banesë, të vlerësuara në shumën e përgjithshme prej 31 165 811 (tridhjetë e një milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e njëmbëdhjetë) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2004, zëri “Investime”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 230 000 (dyqind e tridhjetë mijë) lekë dhe të përballohet nga bashkia e Vlorës.

6. Punimet të përfundojnë brenda muajit dhjetor të vitit 2004.

7. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë brenda muajit dhjetor 2004.

8. Pronarët e përcaktuar në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të cilët në kolonën “Shënime” janë konfirmuar nga zyra e regjistrimit, por kanë mungesë kartelesh të pronësisë apo janë në proces regjistrimi, do të marrin shpërblimin për efekt të shpronësimit pasi të jenë pajisur me dokumentacionin e plotë ligjor nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Deri në atë çast paratë do të jenë të bllokuara në bankë.

9. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA “REHABILITIMI I KUZ PËR RRUGËN NË
VERI TË ISH-KOMBINATIT TË KONSERVAVE”**

1. Për truallin

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë truall	Çmimi i tokës/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)	Shënim
1.	Trashëgimtarët e Z. Kanan Çipi 1. Enver Çipi 2. Pranvera Çipi (Rexhepi) 3. Luan Çipi 4. Bektash Çipi 5. Teuta Çipi (Reçi)	2044.5 m ²	2242	4 583 769	Plotësim dokumentacioni për regjistrim për tu pajisur me vërtetim pronësie.

2. Për banesën (2 kate)

Nr.	Emri mbiemri	Sip/tokë truall	Çmimi objektit/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)	Shënim
1.	Trashëgimtarët e Z. Kanan Çipi 1. Enver Çipi 2. Pranvera Çipi (Rexhepi) 3. Luan Çipi 4. Bektash Çipi 5. Teuta Çipi (Reçi)	249 m ² x 2 kate = 498 m ²	28 177	14 032 146	Plotësim dokumentacioni për regjistrim për tu pajisur me vërtetim pronësie.

**PRONARËT QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA “SISTEMIM-ASFALTIM RRUGA NR.5
(SEGMENTI SHKOLLA “ALI DEMI”- RRUGA NR.3), NË QYTETIN E VLORËS”**

Nr.	Emri, mbiemri	Sip/tokë truall	Çmimi tokës/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)	Shënim
1.	Ilirjan Sharra Mihrije Sharra Bakije Meçaj	235 m ²	2242	526 870	
2.	Dhiomidh Babe Eftali Nesturi Andon Babe	275 m ²	2242	616 550	
3.	Jorgo Vangjeli Trashëgimtarët e Z. Andon Vangjeli 1. Petraq Vangjeli 2. Arben Vangjeli	117,4 m ²	2242	263 211	Plotësim dokumentacioni
4.	Hasan Çela	255,3 m ²	2242	572 383	Plotësim dokumentacioni për t'u pajisur me vërtetim të ri pronësie.

2. Për banesën

Nr.	Emri mbiemri	Sip/tokë truall	Çmimi objektit/m ² (lekë)	Vlera në (lekë)	Shënim
1.	Ilirjan Sharra Mihrije Sharra Bakije Meçaj	145 m ²	28 177	4 085 665	
2.	Nuri (Bashkim) Sharra	70 m ²	28 177	1 972 390	
3.	Dhiomidh Babe Eftali Nesturi Andon Babe	52 m ²	28 177	704 425	
4.	Bukuroshe Veliu	63,16 m ²	28 177	1 779 659	Plotësim dokumentacioni për t'u pajisur me vërtetim të ri pronësie.
5.	Hasan Çela	25,5 m ²	28 177	718 513	Plotësim dokumentacioni për t'u pajisur me vërtetim të ri pronësie.
6.	Fati Rama	46.5 m ²	28 177	1 310 230	Plotësim dokumentacioni për t'u pajisur me vërtetim të ri pronësie.

Vlera totale është 31 165 811 (tridhjetë e një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë e tetëqind e njëmbëdhjetë) lekë.

Pronarët e kësaj liste, të cilët në kolonën shënime janë konfirmuar nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, por duhet të plotësojnë dokumentacionin sipas kriterëve të ligjit nr.7843, datë 13.7.1997, do të marrin shpërblim për efekt të shpronësimit, pasi të jenë pajisur me dokumentin e plotë ligjor, nga ZRPP, deri në atë moment lekët do të jenë të bllokuara në bankë.

VENDIM

Nr.899, datë 29.12.2004

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS SË VARREZAVE TË REJA, NË QYTETIN E SHIJAKUT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës së varrezave të reja, në qytetin e Shijakut.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Shijakut.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 523, 6 m², e vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 523 600 (pesëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind) lekësh.
 4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën 235 000 (dyqind e tridhjetë e pesë mijë) lekë.
 5. Fondi prej 758 600 (shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind) lekësh, të përballohet nga bashkia e Shijakut, e cila të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.
 6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në muajin janar 2005.
 7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe bashkia e Shijakut për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS SË VARREZAVE NË QYTETIN E SHIJAKUT

Nr.	Emri	Sipërfaqja	Çmimi në lekë	Vlera në lekë
1.	Sali Keçi	153.6 m ²	1000	153 600
2.	Pëllumb Keçi	130.6 m ²	1000	130 600
3.	Artan Keçi	63 m ²	1000	63 000
4.	Asllan Keçi	176.4 m ²	1000	176 400

Vlera totale e shpronësimit është 523 600 (pesëqind e njëzet e tre mijë e gjashtëqind) lekë.

VENDIM Nr.901, datë 29.12.2004

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.243, DATË 26.3.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE NË MINISTRITË DHE INSTITUCIONET BUXHETORE, PËR VITIN 2004, DHE PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 14 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.243, datë 26.3.2004 të Këshillit të Ministrave, në lidhjen nr.1, “Numri i punonjësve buxhetorë për vitin 2004”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, numri i punonjësve të Ministrisë së Mjedisit bëhet “102 veta”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.906, datë 19.12.2004

**PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT MBIKËQYRËS TË
EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 64 të ligjit nr.8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe të nenit 7 të ligjit nr.9165, datë 23.12.2003 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2004”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e Komisionit Mbiqëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale përfitojnë, për çdo mbledhje, një shpërblim fiks prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh. Pavarësisht nga numri i mbledhjeve të zhvilluara, masa e shpërblimit, për çdo periudhë 3-mujore, nuk duhet të jetë më e madhe se 30 000 (tridhjetë mijë) lekë.

2. Anëtarëve të Komisionit Mbiqëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, për shërbime jashtë vendbanimit të tyre, u paguhen shpenzimet e udhëtimit dhe dietat, në përputhje me aktet ligjore në fuqi.

3. Anëtarët e Komisionit Mbiqëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve Penale përfitojnë, pa pagesë, kopje të Fletores Zyrtare dhe të botimeve të dispozitave ligjore, që lidhen me sistemin e drejtësisë e, në mënyrë të veçantë, me sistemin e burgjeve.

4. Shpenzimet për veprimtarinë e këtij komisioni të përballohen nga fondet e parashikuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të shtetit, të miratuar për Ministrinë e Drejtësisë.

5. Efektet Financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të fillojnë në datën 1 janar 2005.

6. Vendimi nr.612, datë 17.11.2000 i Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e anëtarëve të Komisionit Mbiqëqyrës të Ekzekutimit të Vendimeve me burgim”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministria e Drejtësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.19, datë 23.12.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Zija Vuci	Anëtar i “ “
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Pllloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 21.6.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.17 Akti që i përket:

KËRKUES: FOTO ÇELO, OLIMBI JARAZI, ELENI DHIMARKO, EVANTHI PUCI, përfaqësuar nga avokat Abaz Brati, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: SOFOKLI E LLAZO ÇELO, përfaqësuar nga avokat Viktor Konomi, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.93, datë 3.10.2003 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/1 e 131/f të Kushtetutës, si dhe nenet 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

Kërkuesit kanë parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetues të vendimit të Gjykatës së Lartë:

- Gjykata e Lartë u ka mohuar të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës dhe ka vepruar në kundërshtim me nenin 496 të Kodit të Procedurës Civile, sipas të cilit, afatet e paraqitjes së kërkesës për rishikim lidhen dhe ecin me marrjen në dijeni të shkakut të rishikimit (në rastin konkret zbulimin e provave të reja) dhe jo me ditën kur vendimi ka marrë formë të prerë;

- Interpretimi i nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile për afatet prekluzive të ankimit e rishikimit, është bërë jashtë konceptit të rishikimit dhe në kundërshtim me nenet 495-496 të Kodit të Procedurës Civile, që afatet i lidhin me dijeninë e palës për shkakun e rishikimit;

- Vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë e bën efektivisht të pazbatueshëm institutin e rishikimit.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kujtim Puto, përfaqësuesit e kërkuesve dhe të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë me vendimin nr.708, datë 27.7.1995 ka njohur bashkëpronësinë e Kosta e Anastas Çelos mbi një shtëpi banimi. Ajo ka anuluar gjithashtu vendimin e Komisionit të Kthimit dhe të Kompensimit të Pronave, pranë bashkisë Sarandë, dhe u ka kthyer shtëpinë subjekteve të interesuara (trashëgimtarë të Kosta e Anastas Çelos). Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr.490, datë 16.2.1996 dhe nga Kolegji Civil i Gjykatës së Kasacionit me vendimin nr.1428, datë 8.10.1996.

Kërkuesit, duke pretenduar se janë zbuluar dokumente të reja që nuk diheshin më parë dhe objektivisht nuk mund të paraqiteshin gjatë shqyrtimit të çështjes, kanë paraqitur kërkesë për rishikim të vendimit të gjykatës. Sipas kërkuesve, këto dokumente provojnë pronësinë e trashëgimlënësit të tyre Vangjel Çelo dhe jo të trashëgimlënësve të subjekteve të interesuara. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr.93, datë 3.10.2003 nuk ka pranuar kërkesën me arsyetimin se është paraqitur jashtë afatit njëvjeçar nga dita e shpalljes së vendimit objekt rishikimi.

Objekti i shqyrtimit të Gjykatës Kushtetuese është shfuqizimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë për zgjidhjen e një çështjeje konkrete dhe në këtë këndvështrim, Gjykata Kushtetuese, nuk gjen elemente të një procesi të parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Për nxjerrjen e konkluzioneve të veta kjo Gjykatë do të respektojë parimet e njohura se ligji prezumohet në pajtim me Kushtetutën, përderisa nuk është ndryshuar apo shfuqizuar dhe se është kompetencë e gjykatave të sistemit gjyqësor, ashtu si e çdo organi tjetër shtetëror, për ta interpretuar dhe zbatuar ligjin.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në çështjen në shqyrtim, i është referuar nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile, duke arritur në përfundimin se kërkuesi e ka paraqitur kërkesën për rishikim (me rastin e zbulimit të provave të reja) tej afatit njëvjeçar nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë.

Interpretimi i ligjit duke përcaktuar përmbajtjen e tij është atributi i organeve që e zbatojnë atë. Duke u nisur nga ky parim del se edhe sqarimi i kuptimit të çdo dispozite të Kodit të Procedurës Civile dhe raporti i saj me dispozitat e tjera të përafërta me të për zbatimin e tyre në gjykimet e çështjeve është në kompetencë të gjykatave të sistemit gjyqësor. Në rastin në shqyrtim, Gjykata e Lartë, duke ushtruar kompetencat e veta ka interpretuar Kodin e Procedurës Civile dhe ka arritur në përfundimin se fillimi i afatit të kërkesës së kërkuarve për rishikim nga marrja formë të prerë të vendimit nuk cenon parimet procedurale dhe as përmbajtjen e institutit të rishikimit siç pretendon kërkuarja.

Ky konkluzion i gjykatës nuk ka të bëjë me cenimin e parimeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por me të drejtën dhe njëkohësisht detyrimin kushtetues të ligjor për të përcaktuar dispozitën që duhet të zbatohet në çështjen në gjykim në raport me vlerësimin e provave dhe me hapësirat për interpretim që lënë këto dispozita. Vetë Kodi i Procedurës Civile ka parashikuar momentin e fillimit të afatit të kërkesës për rishikim në dy dispozita dhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke ushtruar të drejtat e veta, ka përcaktuar dispozitën konkrete që duhet zbatuar për të zgjidhur çështjen.

Gjykata Kushtetuese, arrin gjithashtu në përfundimin se nuk kemi mohim të së drejtës kushtetuese për t'iu drejtuar gjykatës. E drejta e aksesit në gjykatë, si çdo e drejtë themelore mund t'i nënshtrohet kufizimeve. Në rastin në shqyrtim, ligjvënësi ka vlerësuar nevojën e kufizimit me afat për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, vlerësim që lidhet me stabilitetin e marrëdhënieve juridike të krijuara pas dhënies së vendimeve gjyqësore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në mbështetje të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Kam mendim të kundërt me shumicën e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese.

Kërkesën objekt gjykimi, ajo nuk duhej ta rrëzonte, por ta pranonte duke shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin e Gjykatës së Lartë të kundërshtuar nga kërkuarja Foto Çelo. Kjo gjykatë në gjykimin e kësaj çështjeje nuk ka respektuar kërkesat kushtetuese për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Shkelja e kësaj të drejte themelore është e lidhur me interpretimin e zbatimin e gabuar të nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile. Gjykata e Lartë ka arritur në konkluzionin se kërkesa e lartpërmendur me objekt rishikimin e një vendimi civil të formës së prerë, duhet rrëzuar për shkak se është ngritur pas një viti nga dita e shpalljes së këtij vendimi.

Ky konkluzion i saj është rezultat i keqinterpretimit të kësaj norme procedurale, që padyshim ka të bëjë me një prej aspekteve të procesit jo të rregullt ligjor.

Për nxjerrjen e kuptimit të vërtetë të nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile ajo nuk duhej të mjaftohej vetëm me analizën gramatikore të tekstit të tij. Në këtë rast për të arritur këtë qëllim asaj i dille për detyrë që të përdorte edhe llojet e tjera të interpretimit, sidomos atë logjik. Duhet pra që përmbajtjen e kësaj dispozite, e cila ka karakter të përgjithshëm, ta krahasonte me atë të dispozitave të tjera të veçanta të Kodit të Procedurës Civile që rregullojnë institutin e rishikimit. Veçanërisht ajo duhej t'i referohej nenit 496 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë dispozitë thuhet shprehimisht se

kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit, por në çdo rast jo më vonë se një vit nga dita që ka lindur shkakun e rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495 afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë.

Respektimi i këtyre afateve është i detyrueshëm për të gjitha rastet e rishikimit të parashikuar nga neni 494 i Kodit të Procedurës Civile pa përjashtuar edhe atë të zbulimit të rrethanave të reja ose të provave të reja shkresore. Ky është edhe shkakun e vetëm për të cilin është ushtruar kërkesa objekt gjykimi. Në paraqitjen e saj kërkuar i është përmbajtur të dy këtyre llojeve afatesh. Nga aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore del se ai i është drejtuar gjykatës pa kaluar 30 ditë nga dita që ka marrë dijeni për shkakun e rishikimit dhe brenda një viti nga dita që ka lindur ky shkak, kohë kjo që përkon me ditën që Arkivi i Shtetit ka konstatuar ekzistencën e kësaj prove të shkresore.

Në këto rrethana vendimi i Gjykatës së Lartë duhet të shfuqizohet. Ai është rezultat i një interpretimi të gabuar të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile dhe rrjedhojë e shkeljes së normave kushtetuese që garantojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.

Në përgjithësi këto janë shkaqet për të cilat unë nuk pajtohem me vendimin që është marrë me shumicë votash, dhe ndryshe nga shumica isha i mendimit për pranimin e kërkesës.

ANËTARI
Z.Vuci

MENDIMI I PAKICËS

Jemi të mendimit që vendimi nr.93, datë 3.10.2003 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë me të cilin është rrëzuar kërkesa e kërkuarve Foto Çelo etj., për rishikimin e vendimit gjyqësor civil nr.708, datë 25.7.1995, duhet të shfuqizohet si i papajtueshëm me Kushtetutën për këto arsye:

Kërkuarit kanë paraqitur kërkesë për rishikim duke pretenduar se kanë zbuluar prova të reja që po të analizohen në harmoni me provat e administruara më parë nga gjykatat do të hedhin dritë mbi pronësinë e banesës dhe do t'i japin çështjes një zgjidhje tjetër. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pa i hyrë fare vlerësimit të rasteve për rishikim të përcaktuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile rrëzon kërkesën me arsyetimin se kërkesa është paraqitur tej afatit njëvjeçar nga dita që vendimi ka marrë formë të prerë.

Kodi i Procedurës Civile përmban dy dispozita për momentin e fillimit të afatit të kërkesës për rishikim. Neni 445 i Kodit të Procedurës Civile e lidh këtë moment me shpalljen e vendimit, ndërsa neni 496 fillimin e afatit e ka të lëvizshëm, duke e kushtëzuar me marrjen dijeni të shkakut të rishikimit, d.m.th. me zbulimin e provave të reja. Gjykata e Lartë, ka pranuar momentin e shpalljes së vendimit sipas nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile.

Në rastin në shqyrtim, për mendimin tonë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, ka zhvilluar një proces jo të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues. Ai i ka mohuar kërkuarve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës e për t'u dëgjuar prej saj dhe e ka bërë efektivisht të pazbatueshëm institutin e rishikimit, gjë që është me pasoja negative si për të drejtat e qytetarëve, ashtu dhe për vetë sistemin e drejtësisë.

Është e vërtetë që Kodi i Procedurës Civile parashikon në dy dispozita momente të ndryshme të fillimit të afatit të kërkesës për rishikim. Këto dy dispozita sintetizojnë parimet e procesit të rregullt ligjor dhe atë të sigurisë juridike. Secili prej këtyre parimeve ka rëndësinë e vet, por në raportin midis tyre nuk mund të mbivlerësohet parimi i sigurisë juridike siç ka vepruar Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke pranuar si afat të kërkesës afatin njëvjeçar nga dita e dhënies së vendimit.

Me vendimin e vet Kolegji Civil, nuk ka ruajtur gjithashtu raportet midis parimeve të rivendosjes të së drejtës e mohimit të së drejtës. Sipas mendimit tonë, neni 445 i Kodit të Procedurës Civile, në çështjen në shqyrtim, i mohon të drejtën (ose ia kufizon shumë atë), palës që ka zbuluar provat e reja për t'i paraqitur e për t'u dëgjuar për përmbajtjen e tyre, ndërsa neni 496 i Kodit të Procedurës Civile, duke përcaktuar fillimin e afatit të kërkesës për rishikim, me momentin e

zbulimit të provave të reja, pranon parimin e rivendosjes të së drejtës. Pikërisht këtë të fundit, duhej të respektonte më tepër Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në vendimin e tij.

Neni 445 i Kodit të Procedurës Civile, hyn në pjesën e tretë të kreut të parë të Kodit të Procedurës Civile, e cila bën fjalë për ankimet e afatet e tyre, ndërsa neni 496 i Kodit të Procedurës Civile, bën pjesë në kreun ku trajtohet në mënyrë të shtjelluar instituti i rishikimit. Pikërisht në raportin midis dispozitës së përgjithshme e dispozitës konkrete merr përparësi dispozita konkrete e aq më tepër kur kjo dispozitë është në favor të së drejtës së palës.

Jemi dakord me mendimin e shumicës që interpretimi e zbatimi i ligjit për zgjidhjen e çështjeve është kompetencë e gjykatave të sistemit gjyqësor, por kur nga ky interpretim cenohen të drejtat themelore për një proces të rregullt ligjor, Gjykata Kushtetuese ka në kompetencë shqyrtimin e kushtetutshmërisë së atij vendimi gjyqësor.

Prandaj, përsa sipër, jemi të mendimit që vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, duhej të shfuqizohej si i papajtueshëm me Kushtetutën.

ANËTAR
K.Puto

KRYETAR
Gj.Sauli

VENDIM
Nr.20, datë 23.12.2004

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Alfred Karamuço	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “
Kristofor Peçi	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Plloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Kujtim Puto	Anëtar i “ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 20.10.2004, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.21 Akti që i përket:

KËRKUES: RAMIZ DAUTI

1. **SUBJEKTE TË INTERESUARA: KOMISIONI QENDROR I CAKTIMIT TË AFTËSISË PËR PUNË**, përfaqësuar nga Avokati i Shtetit, Delo Isufi, me autorizim.

2. **INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE**, përfaqësuar nga Mirela Selita, drejtore e drejtorisë juridike, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimeve nr.3587, datë 9.6.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.1068, datë 9.10.2003 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.581, datë 5.3.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 52 e 131/f të Kushtetutës.

Kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe për shfuqizimin si antikushtetuese të vendimeve të mësipërme:

- Rregulli i shprehur në nenit 35 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” se vendimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë është i formës së prerë, ka të bëjë me “gjykimin administrativ”, por nuk përjashton kontrollin gjyqësor mbi veprimtarinë e atij komisioni. Mënjanimi i këtij kontrolli cenon parimin kushtetues të ndarjes së pushteteve;

- Komisioni Mjekësor Epror i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCAP) Tiranë, nuk ka zhvilluar një proces të rregullt administrativ, sepse e ka shqyrtuar ankimin e tij me shumë vonesë. Jo vetëm kaq, por shqyrtimi i çështjes dhe ekzaminimi i tij në Komisionin Epror është bërë nga mjekë jo kompetentë;

- KMCAP, Epror ka rënduar pozitën e tij si ankues, sepse ndryshoi vendimin e komisionit të rrethit në disfavorin e tij;

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, nuk ka respektuar parimin e procesit gojor, sepse nuk ka dëgjuar drejtpërdrejt pretendimet e tij.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Kujtim Puto, kërkuesin, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCP) Dibër, me vendimin nr.657, datë 28.9.2001, i ka njohur kërkuesit të drejtën e invaliditetit të grupit të katërt për periudhën 16.3.2001-30.3.2002. Kundër këtij vendimi kërkuesi është ankuar në (KMCAP) Epror dhe ky i fundit me vendimin nr.7, datë 30.1.2003, ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk është invalid, por, i aftë për punë në profesionin që ka pasur.

Kundër vendimit të Komisionit Epror kërkuesi është ankuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e cila, me vendimin nr.2587, datë 9.6.2003, ia ka rrëzuar kërkesën me arsyetimin se ai nuk mund të ankohet në gjykatë përderisa, sipas nenit 35 të ligjit nr.7703, datë 11.5.2003 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, vendimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore është i formës së prerë.

Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr.1068, datë 9.10.2003, pranon se vendimi i KMCAP Epror është i formës së prerë përse i përket caktimit të aftësisë për punë, por, ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, ka pranuar të shqyrtojë çështjen përse i përket pretendimeve që ka ngritur kërkuesi në padi për zhvillimin e një procesi të parregullt nga ky komision administrativ. Kështu, ajo ka shqyrtuar pretendimet për përbërjen e komisionit dhe aftësinë e tyre profesionale duke konkluduar se jo vetëm që kjo përbërje ka qenë e rregullt, por edhe që anëtarët e komisionit ishin mjekë specialistë të kualifikuar, të caktuar si të tillë nga Ministria e Shëndetësisë.

Duke qëndruar çështja si më sipër, Gjykata Kushtetuese nuk konstaton që gjykata e apelit të ketë zhvilluar një proces të parregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Në pajtim me dispozitat kushtetuese, si dhe me dispozitat procedurale civile e administrative që kanë të bëjnë me të drejtën e çdo individi për të bërë ankim ndaj çdo akti administrativ, gjykata e apelit, ndryshe nga gjykata e rrethit, i ka hyrë në aspektin procedural problemeve të ligjshmërisë së aktit të komisionit. Ajo ka arritur në përfundimin se komisioni epror përbëhej nga mjekë specialistë të kualifikuar e të aftë profesionalisht, të caktuar si të tillë nga Ministria e Shëndetësisë. Ajo ka pranuar njëkohësisht se verifikimi i aftësisë konkrete për punë ka të bëjë me vlerësimin e bindjen profesionale të anëtarëve të komisionit epror. Vetë natyra e vendimit të komisionit përse i përket gjendjes shëndetësore të kërkuesit e ka çuar gjykatën në konkluzionin se ndjekja strikte e procedurës nuk do të sjellë ndonjë vlerësim më të saktë dhe si rrjedhojë as në ndryshim të vendimit të komisionit epror.

Kërkuesi pretendon gjithashtu se komisioni epror e ka lënë pa grup invaliditeti, megjithëse komisioni në rreth e ka përcaktuar invalid të grupit të katërt. Përse i përket këtij pretendimi, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se është e drejta e organeve të administratës dhe e gjykatave të sistemit gjyqësor për t'i dhënë zgjidhje konkrete e ligjore çështjes duke interpretuar e zbatuar Kodin e Procedurave Administrative.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 132 të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
11.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

DOLI NGA SHTYPI

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 12.1.2005

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë